



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2021:118882

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05805951

**Ac.nr.5842/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naim Mehulli kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Faton Ademi anëtar të kolegjit, i në çështjen juridike-kontestimore të paditësit H.K nga fsh....., I....., të cilën me autorizim e përfaqëson Fatmir Kurmehaj avokat në Pejë kundër të paditurës Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i kualifikimit pa shkëputje nga puna, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Istog- Departamenti i Përgjithshëm C.nr.345/2021, i datës 12.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.06.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Istogut –Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë- Dega në Istog –Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.345/2021, i datës 12.07.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.345/2021, i datës 12.07.2022 ka vendosur si në vijim: **I.APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.K nga fsh....., I....., ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguajë paditësit, në emër të kompensimit 10% të pagës mbi bazë të kualifikimit për periudhën kohore prej dt. 18.04.2017 e deri më 31.12.2020 apo për 44 muaj pune (për secilën muaj të pranisë në punë shumën nga 20.98 €), shumën e përgjithshme prej 92,12 €, me kamat ligjore prej 8 % nga data 14.06.2021 e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditorë nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm. **II. OBLIGOHET** e paditura Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën t’ia aprovojë si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e atakuar C.nr.345/21 të datës 12.07.2022 ta prishë dhe ta hedhë poshtë padinë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

I autorizuari i paditësit me përgjigjeje në ankesë ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet në tersi.

#### **-Ankesa është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit së saj, me datë 14.06.2021 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, të precizuar me të cilën ka kërkuar diferencën e pagës për shkak të kualifikimit apo licencimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.345/2021, i datës 12.07.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë. E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor. Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimin për shkak të mosbindjes, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimin në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Tutje Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se themelësia e kërkesëpadisë për paditësen del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga kontrata me nr. te protokollit 05.nr.1044/13 e dt. 04.09.2013, e lidhur në mes të paditurës dhe këtu paditëses, nga aktvendimi mbi licencim dhe licenca me nr. 100019247 e dt. 13.12.2013, si dhe nga vërtetimi e lëshuar nga ANK-Pejë, vërtetohet se paditësi ka të kryer Shkollen e Mesme Normale "A....." në Pejë në vitin 1978-1979, po ashtu vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura si dhe vërtetohet se paditësja është pajisur me licencë të karrierës, kurse nga Lista e pagave Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet paga bazë të cilën e realizon paditësja.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitivin e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ku ka marrë datën e ushtrimit të padisë ( data 14.06.2021), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive te detyrimit.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitivin e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet 104 € për përpilim padisë dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20€, apo në shumë të përgjithshme prej 124 €.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitivave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë

të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në parashkrim të në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) sepse dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin si dhe i njëjti nuk mund të ekzaminohet nuk qëndrojnë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Pretendimi se kompensimi i tillë nuk parashihet me Ligj të Punës e as me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj gjykata gabimisht ka vendosur në këtë çështje nuk qëndron, sepse Ligji i Punës në raport me këto kategori të referon në Kontratë Kolektive gjë që kjo sipas Kontratës Kolektive parashihet dhe se mbi këtë bazë paditëses i takon kompensimi.

Mungesa e linjës së veçantë buxhetore nuk nënkupton lirim nga përgjegjësia e të paditurës pasi raporti në mes të nivelit lokal dhe atij qëndror nuk afekton në të drejtën e paditëses për kompensim.

Me nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe përfaqësuesit të paditëses të sektorit të arsimit, Ministria ka marrë obligime në emër dhe llogari të të paditurës, ndërsa obligimi për kompensim bie mbi të paditurën pasi është punëdhënës i paditëses. Koordinimi ndërmjet nivelit lokal (Komunës) dhe nivelit qëndror (Qeverisë-Ministrisë) nuk afekton në të drejtën e paditëses.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por vlerëson se të njëjtat nuk qëndrojnë dhe se nuk kanë peshë në vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton të provohet fakti se paditëses me aktvendimin mbi licensimin e mësimdhënësit të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me nr. të protokollit 100019247 i është pranuar kërkesa për licensim.

Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin, nr.01/33, i datës 29.08.2008 në pikën 1 ka vendosur që: *Nga 1 shtatori i vitit 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të licensimit, ndërsa pika 4 ka përcaktuar se: "Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: 1) Me diplomë të shkollës normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2) Me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19% 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%, 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%"*

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se paditësi ka diplomë të shkollës normale, ku në bazë të saj është mësimdhënës i ciklit fillor, ndërsa nga lista e pagave vërtetohet se paditësja ka pagën bazë në shumë prej 421 euro, kualifikimin me shkollë të normale, ndërsa diferenca i është paguar në shumë prej 21,60 euro, mirëpo nuk ju ka paguar pjesa tjetër e cila do të arrinte shumen e 10% të pagës bazë, krejt kjo duke u bazuar në përgatitjen shkollore të paditësit, të paraparë me dispozita ligjore

Në rastin konkret, Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur kur paditëses i është aprovuar kërkesëpapia edhe lidhur me kompensimin e diferencës në pagë në emër të licensimit, ani pse Gjykata e Shkallës së parë është thirrur se kjo e drejtë është përcaktuar me Kontratën Kolektive të Arsimit, kjo Gjykatë vlerëson se kjo e drejtë nuk derivon nga Kontrata Kolektive e Arsimit edhe pse është e përcaktuar me të. Ky përfundim i Gjykatës së Apelit, vie edhe nga **Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës, G.J.A-Su.A, 214/2023, i datës 05.10.2023,** ku është përcaktuar se për kërkesa e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licensimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, i datës 29.08.2008.

Pra vendimi i Qeverisë së RKS, ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023 deri në periudhën kur edhe është shfuqizuar, dhe ky vendim që është dashur që të zbatohet që nga dita e nënshkrimit e deri në momentin kur ka qenë në fuqi, e që e paditura duke vepruar në kundërshtim me këtë vendim i'a ka mohuar paditëses një të drejtë që i ka takuar. .

Gjykata e Apelit vlerëson se çështja e asaj se paditësi paguhet sipas kontratës së punës që dhe i njëjti është paguar gjegjësisht ka marr shtesën në shumë prej 21.60, ky pretendim është tejet irrelevant, pasi që kemi një Vendim të vetë Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka pasur karakter detyrues dhe si i tillë është dashur detyrimisht të zbatohet, pavarësisht asaj se çka është përcaktuar me kontratë sepse me kontratë përcaktohet fillimisht paga bazë, ndërsa sa i përket shtesat janë përcaktuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, i datës 29.08.2008 .

Sa i përket afatit të licencës, me [Udhëzimin Administrativ me nr. 5/2017 sistemimi i licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë](#), ne nenin 31 paragrafi 1.1 përcaktohet se “Vazhdohen për pesë vjet licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014. Licencat e lëshuar në këto vite mbeten të vlefshme deri në përudhën e realizimit të VPM”. Në rastin konkret paditësi është pajisur me licencë me dt.13.12.2013, e ne bazë të udhëzimit administrativ të lartcekur të njëjtit i është vazhduar licenca edhe për 5 vite, e që nënkupton qe për vitet qe ka kërkuar kompensim në emër te licëneses i njëjti ka pasur licencë valide.

Gjykata e Apelit lidhur me pretendimin për parashkrim nga ana e të paditurës e refuzon si të pathemeltë për faktin se një pretendim i tillë nuk qëndron dhe nuk e pranon kjo gjykatë sepse me nenin 180.3 të LPK-së në mënyrë të qartë përcaktohet se “Prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”, andaj në këtë fazë të procedurës nuk mund të vlerësohet ky pretendim sepse pala ankimore gjatë procedurës në gjykatën e shkallës së parë nuk është thirrur në parashkrim.

Lidhur me kamatën është vendosur konform nenit 382 të LMD-së. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.5842/2022 me datë 11.06.2024**

**Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari**  
**Naim Mehollli**